



KONTRATA SOCIALE PUKË

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

SHTATOR 2021-SHTATOR 2022

Viti i III-të i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
LËVIZJA RINORE PËR DEMOKRACI



RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE VITI I TRETË I MONITORIMIT

BASHKIA PUKË

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Shtator 2021 – Shtator 2022

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve, projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Centre” në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
- “Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, Durrës;
- “Qendra Rinore”, Vlorë;
- “Shoqata për Integrimin e Zonave Informale”, Kamez;
- Qendra “Epoka e Re”, Fier;
- Qendra “Intelektualët e Rinj Shpresë”, Shkodër;
- “Lëvizja Rinore për Demokraci”, Pukë;
- “Qendra Rinore për Progres”, Kukës;
- Qendra “Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim”, Progradec;
- Qendra “Tjetër Vizion”, Elbasan;
- Qendra “Gruaja në Zhvillim”, Korçë;
- Qendra “Hapa të Lehtë”, Vau i Dejës.

Ky Raport është Përgatitur nga Qendra “Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë” në kuadër të projektit POP “Përballja e Ofertave Politike”, “Monitorimi i zbatimit të Kontratës Sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy”. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE.....	6
METODOLOGJIA.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
GJETJE KRYESORE.....	9
PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE	10
MONITORIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK	11
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE:	11
PRIORITET 1:.....	11
PRIORITETI NR. 2	12
PRIORITET 3:.....	13
PRIORITET 4:.....	13
PRIORITET 5:.....	13
PRIORITET 6:.....	13
PRIORITET 7:.....	14
PRIORITET 8:.....	14
PRIORITET 9:.....	15
PRIORITET 10:.....	15
PRIORITET 11:.....	15
PRIORITET 12:.....	16
PRIORITET 13:.....	16
PRIORITET 14:.....	16
GJETJE GJATË TAKIMEVE ME KOMUNITETIN	17
REKOMANDIME	18
ANEKSE	19
ANEKS 1: PRIORITETET E KONTRATËS SOCIALE	19

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
KMACP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë
KEMP	Asistencë për pa-aftësi për punë
Fëmijët me AK	Fëmijë me aftësi të kufizuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
BTF	Bashki të Forta
COVID 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	Prioritetet kryesore të identifikuar gjatë vitit 2019
LRD	Qendra Rinore Puke
GADC	Aleanca Gjimore për Zhvillim

Falenderime

Për të hartuar këtë raport të monitorimit të Bashkisë Pukë për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë administratën e Bashkisë Pukë për bashkëpunimin dhe informacionin e ofruar.

Falenderojmë qytetarët që janë pjesë e procesit të përcaktimit të prioriteteve të kontratës sociale dhe vazhdojnë të jenë pjesë e procesit përmes monitorimit, raportimit, takimeve të ndryshme që organizata lokale ka zhvilluar përgjatë kësaj kohe, anëtarët e rrjetit POP si edhe Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC), organizata lider në “Përballja e Ofertave Politike-(POP)”, të cilët po na ndihmojnë nëpërmjet një bashkëpunimi të mire, që LRD të përmbushë detyrat e përcaktuara gjatë zbatimit të këtij projekti.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Kontrata Sociale në Pukë¹ përmban 16 prioritete që qytetarët e Pukës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra “Levizja Rinore per Demokraci ” (LRD), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. LRD mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Pukë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Pukë u realizuan 50 % e prioriteteve të qytetarëve. Gjatë vitit të dytë të monitorimit për përmbushjen e kontratës sociale, bashkia e Pukës arriti të adresonte 65% të prioriteteve të kësaj kontrate duke i hapur rrugë kështu rivlerësimit nga ana e Bashkisë edhe të prioriteteve të tjera të dala nga takimet periodike mes komunitetit dhe Qendrës “Levizja Rinore per Demokraci”.

¹ Kontrata Sociale me bashkinë Pukë: <https://popnetëork.al/wp-content/uploads/2020/07/Puka-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Raporti² i vitit të parë monitorues dhe raporti³ i vitit të dytë monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Pukë si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit, gjatë vitit 2022, projekti vazhdoi me “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.

Gjatë vitit të tretë të monitorimit Organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet; Ndwrkohw qw nuk ka njw tw dhwnw sa i pwrket mbledhjeve tw kwshillit bashkiak, edhe pse nw pukw ky mekanizwm
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁴ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

² Raporti I vitit të parë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Puke.pdf

³ Raporti I vitit të dytë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti-POP_Bashkia-Puke.pdf

⁴ Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022 <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-Studimor-Bashkia-Puke-2022.pdf>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, LRD, anëtare e rrjetit POP u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Pukë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022;
- U organizuan takime me sektorët kyç të administratës së Bashkisë, Administratorë të Njësive Administrative dhe qytetarë të Pukës, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit të Pukës;
- U realizuan fokus-grupe me pjesmarrje të përfaqësues të komunitetit, të rinj, organizata lokale dhe institucione vendore të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë vitit të parë.
- U monitorua në vazhdim puna e Këshillit Bashkiak Pukë, mbledhjet e organizuara gjatë pandemisë si edhe mbledhjet në vend.
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë.
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak.
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave active kryesisht on-line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022.

Kjo periudhë përfshin aktivitetin e qeverisjes vendore, riprezantimin me prioritetet e Kontratës Sociale, takime publike në kuadër të Kontratës Sociale dhe takime me komunitetin për t'i informuar se sa është përmbushur Kontrata Sociale si dhe evidentimin e të tjera problemeve që prekin banorët si edhe monitorimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe të zbatimit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

Gjatë muajve Shtator 2021 – Shtator 2022 organizata kishte si qëllim:

- Të zhvillonte takime ku do të prezantonte përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale dhe monitorimin për vazhdimin e përmbushjes së prioriteteve të tjera;
- Të monitoronte Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportonte gjetjet dhe rekomandimet;
- Të lobonte dhe advokonte për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.

Përmbledhje ekzekutive

Gjetje Kryesore

- Gjatë periudhës Shtator 2021 – Shtator 2022, procesi i monitorimit nga Qendra Rinore ka vazhduar njësoj si në vitin paraardhës. Bashkëpunimin me Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak e konsiderojmë të mire dhe ata kanë pasur një qëndrim më të hapur në bashkëpunimin me shoqërinë civile.
- I gjithë informacioni i aktivitetit të Bashkisë është ndarë në kohë reale përmes rrjeteve online të komunikimit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e informimit të publikut, në rritjen e transparencës dhe ftesës së hapur ndaj qytetarëve për të qenë pjesë e vendimmarrjes përmes pjesëmarrjes në takime të ndryshme konsultuese apo dëgjesa publike, duke iu ofruar të gjithë informacionin e duhur dhe infrastrukturën për pjesëmarrje.
- Vazhdon të mbetet i ulët interesi i qytetarëve për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes, edhe pse të gjithë vazhdojnë të ankohen kur i preket interesi apo realizohet një investim para një tjetri ndoshta më shumë të nevojshëm për qytetarët.
- Gjatë kësaj periudhe që po mbajmë këtë raport, është vërejtur shtimi i aktiviteteve kulturore nga Bashkia Pukë, duke vënë në funksion Pallatin e Kulturës dhe Qendrën Kulturore për Fëmijë.
- Po ashtu, duhet vlerësuar kujdesi i administratës së Bashkisë për të rritur shërbimet ndaj shtresave në nevojë kryesisht ndaj moshës së tretë të vetmuar.
- Edhe aksionet për mbrojtjen e mjedisit kanë qenë shumë të shpeshta, qoftë në lidhje me pastrimin, mbrojtjen e pyjeve si dhe sensibilizimin e qytetarëve për ambiente të pastra dhe të shëndetshme.
- Është vërejtur rritje e bashkëpunimit të Bashkisë me donatorë e biznesmenë të ndryshëm, të cilët janë ftuar për të investuar për një Pukë të zhvilluar në sektorin e turizmit.

Procesi i formulimit të prioriteteve të Kontratës Sociale

Kontrata Sociale e bashkisë Pukë u hartua sipas një plani konkret dhe metodologjie të përcaktuar paraprakisht. U zhvilluan takime me komunitetin dhe u mbledhën të gjitha problematikat që prekin banorët që jetojnë në Pukë qytet dhe në katër Njësitë Administrative Gjegjan, Qelez, Rrapë e Luf – Qerret.

Publikimi i prioriteteve të kontratës sociale

Çështjet e diskutuara me fokus grupet e qytetarëve janë përfshirë në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:

1. Zhvillimi ekonomik vendor
2. Shërbimet publike
3. Dimensioni social
4. Demokracia vendore

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve, prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;

U formuluan dhe listuan sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti, 14 prioritetet të cilat janë të bashkëngjitura si aneks në këtë raport.

Këto prioritetet u listuan dhe u votuan në takime me fokus grupe të ndryshme, kryesisht të rinj e gra, ku iu dha prioritet të gjitha kërkesave që paraqitëm në Kontratën Sociale, e cila i është prezantuar administratës së Bashkisë, Këshillit Bashkiak dhe kryetarit të Bashkisë, në takime publike me pjesëmarrje të gjërë të komunitetit, kontrata e hartuar nga Qendra Rinore ka shërbyer që, në planet e Bashkisë të futen pikërisht këto prioritetet, po ashtu edhe në planet e investimeve edhe në detajimin e prioriteteve të përcaktuara nga administrata e Bashkisë dhe që miratohet në Këshillin Bashkiak në fillim të vitit.

Pas monitorimit të vitit të dytë të kësaj kontrate (Shtator 2020 – Shtator 2021), ku kishte një realizim me rreth 60 % në listën e prioriteteve që Bashkia ndërmori për t'i adresuar, gjatë vitit

2021 – 2022, u vërejt se është arritur plotësimi rreth 70 % i këtyre prioriteteve që parashikohen në Kontratën Sociale, kryesisht prioritete që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës

rrugore, furnizimit me ujë të pijshëm, kanalet vaditëse, kanalizime të ujrave të përdorura, dhe një rëndësi e veçantë po i jepet zhvillimit të turizmit si një fushë shprese për të rinjtë, gratë dhe komunitetin në përgjithësi.

Monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Qendra Rinore ka monitoruar të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2021 – Shtator 2022, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid 19 në disa raste janë zhvilluar online ose pa praninë fizike të qytetarëve por me mundësinë për t'i ndjekur ato në platforma të ndryshme. Vlen për tu theksuar përmirësimi i infrastrukturës teknologjike/digjitale, pasi çdo zhvillim i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak është transmetuar dhe live për të gjithë komunitetin që ka pasur dëshirë për të dëgjuar dhe për tu informuar rreth vendimarrjes. Këshilli i Bashkisë përbëhet nga 15 anëtarë, nga të cilët 3 gra e 12 burra dhe të gjithë i përkasin krahut të majtë politik.

Në çdo mbledhje të Këshillit Bashkiak ka qenë pothuajse i njëjti rend dite dhe nuk kemi ndeshur në një mbledhje që të kishte vendimarrje në lidhje me ndonjë nga pikat e kontratës sociale, përjashtim bën mbledhja e muajit Shtator 2022 ku u miratua lista e përfituesve të apartamenteve të ristrukturuara nga bashkia në pallatin e NSHN-së.

Njoftimi i orareve të zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit dhe projektpropozimet sipas rendit të ditës, janë bërë të dituara përmes faqes së Bashkisë në rrjetet sociale, në këndin e njoftimit dhe njoftime përmes administratës në Njësitë Administrative, për të gjithë të interesuarit që kanë pasur dëshirë për të ndjekur këto mbledhje fizikisht apo dhe online.

Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale:

Prioritet 1: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Të injtë e sapo diplomuar
- Gratë
- Gratë viktimë të dhunës në familje
- Nuk ka akoma një program për nxitjen e punësimit me fokus këto tre grupe, por vërehet punë në zhvillimin e sektorit të turizmit por nuk kemi të dhëna se sa specifikisht janë përfitues të rinjtë apo gratë në këtë sektor, përveq informacionit verbal që ne marrim nga

vëzhgimi i përditshëm i situatës meqenëse Puka është një zonë e vogël dhe lehtësisht vërehen ndryshimet që mund të ndodhin.

- Vlerësojmë punësimin e të rinjve në sektorin publik, afërsisht 50% e punonjësve në sektorin publik të punësuar në vitet e fundit janë të rinj, 22-35 vjeç.
- Është prezantuar një projekt që do fillojë, për ndërtimin e një pike të grumbullimit të produkteve lokale që do të nxiste punësimin e grave kryesisht, i cili ishte parashikuar që mund të niste në muajin Mars 2022, por që nuk ka filluar akoma.

Prioriteti nr. 2

Rregullimi dhe ndërhyrja në rrugët në nivel Bashkie

Në infrastrukturën rrugore u investua dhe u përmirësuan:

- Është realizuar shtresa me asfalt e unazës të qytetit Pukë;
- Është realizuar investimi në sistemimin dhe asfaltimin e rrugës së lagjes “Kukaj”;
- Është realizuar projekti i ndriçimit të një pjese në rrugën e lagjes “Zezaj” në qytetin e Pukës;
- U sistemuan sipërfaqe të gjelbra dhe ndriçim i qendrave të Njësive Administrative Luf e Gjegjan.
- Është përmirësuar dhe rritur kujdesi i mirëmbajtjes së rrugëve rurale në 4 Njësitë Administrative;
- Është ndërtuar urë për kalimin e automjeteve në fshatin Kabash;
- Po ashtu, në disa prej fshatrave të Njesisë Administrative Luf - Qerret është bërë ndërhyrje për përmirësimin e urave të këmbësoreve, të cilat kanë qenë shumë të amortizuara dhe të rrezikshme për banorët si, ura e Lajthizës në Gjegjan, ura te përroi i Rrvishtit në fshatin Midhë të Njesisë Administrative Qelëz, Ura e fshatit Pla në Njësinë Administrative Luf Qerret, ura këmbësore e lagjes “Kukaj”;
- Optimizimi i Rrjetit të Ujësjellësit të Qytetit Pukë;
- Ndërhyrje në përmirësimin e rrugëve rurale të Njësive Administrative si, aksi rrugor rural Ukth – Buzhalë për të bërë të aksesueshëm edhe pikën turistike Maja e Murgës, rrugët e lagjes “Lejthizë” dhe lidhjen me rrugë të gjitha banesave, rruga Pukë – Kabash, Rrape – Kabash, rruga e Meqes, rrugët e fshatrave në Qelëz, segmenti rrugor Katund-lagjia “Qelesh”, sinjalistika dhe tabela për bujtina, restorante dhe parqet e Bletëve, rruga e fshatit Marrnaq dhe rruga e fshatit Plet në Njësinë Administrative Luf-Qerret;
- Bashkia Pukë përvec mirëmbajtjes rutinë të rrugëve rurale, është e angazhuar përgjatë gjithë dimrit për përballimin e situatave të reshjeve, në hapjen e rrugëve nga bora, apo pastrimin e segmenteve të ndryshme rrugore nga ngricat;
- Ndërtimi i ujsjellësit Luf e Gjegjan është në proces.

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i vendosjes së transportit publik, sidomos në ato zona ku ai mungon totalisht.

- E porealizuar, dhe kur kemi pyetur na është thënë se nuk është kompetencë e Bashkisë dhe ne nuk kemi një informacion të qartë nëse është detyrë e Ministrisë së linjës. Por fakti që nuk ka transport publik, po kthehet në problem të madh. Bashkia duhet të kërkojë një shërbim të tillë në ndihmë të qytetarëve të saj. E kemi theksuar se sa shumë do i ndihmonte gjithë zonave ky shërbim, duke filluar që në shkollimin e fëmijëve, aksesin për daljen në treg dhe shitjen e produkteve të fermave, për nevojat e përditshme etj.

Prioritet 4: Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

- Me mbështetjen e UNDP, është hapur Qendra Ditore për fëmijët PAK, ambiente këto të përshtatshme dhe me kushte bashkëkohore si dhe staf në dispozicion për të ofruar shërbime si, psikolog, fizioterapist, logoped. Kjo qendër ofron shërbim për rreth 60 fëmijë me probleme të veçanta dhe ka filluar shërbimin lëvizës në të katër Njësitë Administrative për t'iu ofruar shërbim në banesë. Stafi dhe ambientet janë në dispozicion pesë ditët e javës me orar zyrtar dhe ofrojnë shërbime zhvillimore, okupacionale, terapi fizike. Stafi i angazhuar pranë kësaj qendre do të ofrojë dhe shërbime këshillimore për prindërit e këtyre fëmijëve. Ky është një investim i rëndësishëm dhe që zhvillohet për herë të parë në bashkinë Pukë.

Prioritet 5: Ngritja e programeve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore.

- Me gjithë ndërhyrjen e organizatës për të përmirësuar situatën kundër dhunës me bazë gjinore apo për të bërë funksional mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës, vazhdon të mbetet në hije marrja e masave për këtë prioritet, Bashkia dhe punonjësit e zyrës për barazinë gjinore kanë ndërmarrë fushata të ndryshme ndërgjegjësimi, por nuk kanë një program që mund të ndihmojë, sidomos gratë në situatë dhune.

Prioritet 6: Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në Njësitë Administrative dhe zonat periferike ku ato mungojnë si dhe kontrollimi më i shpeshtë nga Bashkia.

- Shërbime të përmirësuara, sipërfaqe të gjelbra të shtuara dhe të mirëmbajtura, vendosje stolash, mbjellje pemësh, shërbime dekori të realizuara;
- Një kënd pushimi dhe çlodhjeje është krijuar për qytetarët si dhe një kënd lojrash për fëmijë në parkun e liqenit, i cili është kthyer në një atraksion turistik tashmë të preferuar për të gjithë vizitorët dhe banorët e Pukës.
- Është bërë evakuimi i mbetjeve inerte të depozituara në mënyrë të papërgjegjshme nga qytetarë apo biznese që kanë kryer punime të ndryshme dhe inertet më tej i kanë depozituar në kurorën me pisha pranë stadiumit të qytetit të Pukës, duke e kthyer një sipërfaqe të konsiderueshme të degraduar e dëmtuar nga mbetjet në një sipërfaqe të pastër e më vonë të gjelbëruar.
- Vazhdon të jetë problem shtimi i koshave në Njesitë Administrative dhe informim i komunitetit për mbajtjen pastër të ambienteve
- Amortizimi dhe nevoja për ti ndërruar koshat ekzistues,

Prioritet 7: Adresimi dhe rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm i shkollave dhe fshatrave si dhe kontrolli i cilësisë së tij.

- Vazhdon të mbetet problem furnizimi me ujë të pijshëm në shkollat e zonave rurale, edhe pse është një problem i relatuar ndër vite si përmes Kontratës Sociale po ashtu dhe nga vetë komuniteti prindër – mësues.
- Është ndërtuar ujësjellësi i Lufit dhe i Gjeganit, investim që ka përmirësuar jeten e banorëve.

Prioritet 8: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

- Janë zhvilluar takime e konsultime për taksat, por vërehet pjesëmarrje e ulët e komunitetit, sidomos në zonat rurale. Ndryshe ndodh në Pukë qytet ku gjatë takimit të konsultimit të buxhetit, pjesëmarrja ka qenë e lartë dhe është ndjekur dhe online, ku qytetarë të ndryshëm kanë pasur mundësinë të shprehin opinione dhe të propozojnë prioritetet, të cilat janë marrë në konsideratë nga administrata e bashkisë e ngarkuar për përgatitjen e projekt - buxhetit.

Prioritet 9: Ngritja e akademisë sportive (zhvillimi i shumë sporteve për aktivizimin rinor)

- Është ndërtuar Qendra Sportive dhe është në dispozicion të komunitetit. Palestra e ndërtuar në territoret e gjimnazit Pukë, qëndroi për disa kohë e mbyllur dhe pa funksion përveç gjatë orëve të edukimit fizik për shkollën. Me kërkesë ndaj Bashkisë në takime të ndryshme të monitorimit të Kontratës Sociale, kemi shprehur se kjo Qendër Sportive duhet të jëtë në dispozicion të komunitetit, pasi ky ka qenë qëllimi i funksionit të saj që kur është bërë kërkesa për investim dhe kur është ndërtuar. Në mesin e vitit 2021 kjo qendër është vënë në funksion të komunitetit, Bashkia ka përcaktuar një person që të kujdeset për të dhe të interesuarit ta gjejnë gjithmonë hapur dhe në dispozicion. Grupe të ndryshme qytetarësh dhe të rinjsh e përdorin çdo pasdite për sporte të ndryshme si volejboll, basketboll, ushtrime të ndryshme fiskulture etj.
- Po ndërtohet aneksi sportiv dhe kjo një hapsirë dedikuar sporteve në natyrë
- Ka filluar ndërtimi i ZipLine i cili shikohet si vlerë e shtuar në shtimin e numrit të turistëve por dhe mjet argëtimi për banorët vendas,
- Me iniciativë private po ndërtohet pista e skive në koder Hani,

Prioritet 10: Lobimi dhe mbështetja nga bashkia në lidhje me bursat e ekselencës.

- Është miratuar në buxhetin 2021 një shumë 200 000 Lek, për nxënësit e ekselencës dhe në nevojë ekonomike, por nuk është shprehur si zë i veçantë në buxhetin e Bashkisë dhe nuk është shpenzuar për shpërblim të nxënësve të ekselencës deri në këtë fazë të raportimit. Bashkia po bën vetëm promovimin e këtyre nxënësve përmes faqes zyrtare të facebook-ut.
Rreth këtij prioriteti ka vazhduar fushata e lobim advokimit me këshilltarët dhe administratën e bashkisë.

Prioritet 11: Nevoja për hapjen e kurseve profesionale me bazë zhvillimin e aftësive për turizëm, si një fushë prioritare e zhvillimit të Pukës, duke sjellë kështu edhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe grave.

- Nga Bashkia nuk ka një iniciativë ndërsa organizatat e shoqërisë civile kanë patur disa nisma për rritjen e aftësive të të rinjve dhe grave për punë e përgatitje që të ofrojnë shërbime të mira turistike. E vetmja ndërhyrje ishte trajnimi i të rinjëve në zhvillimin e Startup-eve e mbështetur nga ministria e Sipërmarrjes dhe zbatuar nga bashkia.

Prioritet 12: Zhvillimi dhe identifikimi i zonave turistike, tabelat informuese, shtigjet malore, informacion i zgjeruar për zhvillimin e zonës së Pukës.

- Është përmirësuar gjendja, duke u ndërtuar me shënja e tabela informuese shtigjet malore me rreth 25 km dhe po punohet për promovimin e zonës dhe burimet për zhvillim të turizmit.
Mbetet shumë për tu bërë si vendosja në funksion e info-poit dhe punësimi i guidave lokale që shërbejnë njëkohësisht edhe për promovimin e turizmit por edhe shoqërimin e turistëve sipas një kalendari të përcaktuar. Nuk është akoma gati që një biznes në pukë të jetë i bazuar në të ardhurat ekonomike si guidë, pasi numri i turistëve vazhdon të jetë i ulët ndërsa janë mesatarisht 45 ditë në vit që Puka mund të ketë turistë në çdo ditë.

Prioritet 13: Kërkesa për të hapur një Qendër Rinore.

- Edhe pse kjo është një kërkesë e kahershme që në Kontratën Sociale 2015, ajo vazhdon të jetë e parealizuar edhe pse është këmbëngulur në çdo takim që kemi pasur. Që pas vënies në funksion të Qendrës Sportive, është vlerësuar si një hapësirë rinore dhe pjesa tjetër është lënë pas dore.

Prioritet 14: Rishikimi i ndihmës ekonomike veçanërisht për gratë kryefamiljare, të divorcuara dhe ato të dhunuara.

- E papërmirësuar, niveli i shpërblimit për përfituesit e ndihmës ekonomike është shumë e ulët dhe e pamundur për të mbuluar as 10% të shpenzimeve që një familje ka, nuk ka një mbështetje specifike ndaj grave me këto probleme, si dhe nuk është diskutuar asnjëherë në këshillin bashkiak as për rastet specifike as për raste të përgjithshme.

Për çështjet mjedisore:

Bashkia Pukë ka rritur aktivizimin për mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet, prerjet, djegiet, shkatërrimin, po ashtu ka marrë disa herë aksione komunitare për për mbllelle të pyjeve, pastrimin nga mbetjet urbane dhe fushata ndërgjegjësimiti për mbrojtjen e mjedisit.

KANALET KULLUESE VADITËSE

Megjithëse është bërë më herët punë në lidhje me kanalet kulluese vaditëse, aty ku janë ekzistente, në përgjithësi cilësia dhe gjendja e tyre është e mirë. Por, banorët shprehin problematikën e mungesës së këtyre kanaleve në shumicën e fshatrave, si dhe mungesën e pastrimit të tyre (aty ku ekzitojnë).

Prioritet 9/1 komunitar: Ndërtimi dhe rikonstruksioni i kanaleve kulluese/vaditëse në të gjitha zonat ku e kanë të nevojshme si dhe mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese nga ana e Bashkisë. Në lagjet e Qelzës, në çdo takim banorët janë shprehur për nevojën e ndërtimit të kanaleve vaditës.

Në investimet e kullimit dhe vaditjes janë investuar:

- Rehabilitimi i digës të rezervuarit të Kukajve;
- Kanali vaditës i fshatit Qerret në njësinë administrative Luf-Qerret;
- Sektori i shërbimeve ka realizuar përmirësimin e kanalit të vaditjes për 12 familje në Njësinë Administrative Gjegjan.

Realizime për strehimin:

- Bashkia Pukë ka filluar shprëndarjen e apartamenteve, pjesë e kompleksit të banesave sociale ndërtuar nga "Enti Kombëtar i Banesave" në bashkëpunim me Bashkinë Pukë;
- Rikonstruksioni i ish-NSHN, ku ndodhet një pallat pranë Shkollës së Mesme "Sabah Sinani" familjet janë kthyer në banesat e tyre;
- Banesat sociale ishin parë si banesa që përfitohen nga familjet në nevojë por kriteret e vendosura për përfitimin e këtyre banesave ishin për familjet që kanë të ardhura minimale rreth 15000 lek/frymë në muaj, duke vijuar kështu mungesën e banesave për nevojtarët, që mbesin në të njëjtën situatë edhe pas këtij investimi.

Gjetje gjatë takimeve me komunitetin

Një shqetësim i hasur tek banorët është investimi në fasada për të cilin ka banorë që shprehen se nuk janë trajtuar njësoj me banorët e tjerë të të njëjtit pallat apo hyrje. Investimi kishte për detyrë të zëvendësonte dritaret apo vetratat e ballkoneve të amortizuara me të reja, ndërkohë tek disa apartamente i kanë realizuar ndërsa tek të tjera jo, (i referohemi pallatit afër Drejtorisë së Policisë) dhe për këtë kemi dy ankesa nga banorët e pallatit.

Për çështjet e punësimit, kryesisht për të rinjtë dhe grate, nuk ka një plan të miratuar. Duke lënë si shpresë të fikur qëndrimin e të rinjve në Pukë dhe me sytë vetëm nga administrata publike e cila çdo ditë është duke u reduktuar, për shkak të largimit të popullsisë. Situata e biznesit është në nivele shumë të ulëta sa i takon mundësisë së punësimit, e sidomos periudha e Covid19 e ka dëmtuar rëndë edhe atë nivel që ishte arritur më parë.

Në zonat rurale vazhdojnë të mbeten problem kanalet vaditëse, mungesa e tregut për produktet, mungesa e kapaciteteve për aplikime në skemat mbështetëse për fermerët dhe bujqësinë e blegtorinë, subvencione të papërfituara në asnjë rast.

“Na ndihmoni ta bëjmë jetën më të lehtë”, u shpreh një nga zonjat në takimin që realizuam me banorët në Qelez, e cila kërkonte ndërtimin e kanalit të ujit që të vadiste tokën.

Largimi në masë i të rinjëve është kthyer në një problem të madh për të gjithë zonen e Pukës.

Nga takimet me qytetarët dhe intervistat e strukturuar, rezulton:

- 70% e të intervistuarve vlerësojnë punën e Bashkisë Pukë.
- 70% e personave nga zonat rurale mendojnë se investimet në zonat rurale janë minimale. Këto investime kryesisht janë në mirëmbajtjen e rrugëve, urave dhe pastrimin e disa kanaleve kulluese.
- 75% mendojnë se nuk ka programe për të rinjtë, me synim punësimin apo mbështetjen me programe të specializuara për mbështetje financiare për start up-et rinore, nga Bashkia Pukë.
- 65% mendojnë se në lidhje me programet për zhvillimin e grave dhe vajzave, Bashkia Pukë nuk ka zhvilluar programe për rastet e dhunës në familje dhe mungojnë programet për rritjen e kapaciteteve të grave dhe vajzave, në mënyrë që të përgatiten për tregun e punës, kjo sidomos në zonat rurale.
- 75% e të intervistuarve kërkojnë lehtësim të taksave dhe pagesave të ujit dhe dritave.
- 50% nuk kanë informacion në lidhje me mbledhjet e Këshillit Bashkiak, (kjo ka të bëjë me neglizhencën pasi pjesa përdoruese e rrjeteve sociale mund ta gjejë informacionin online).

Rekomandime

- Të fillojë hartimi i një strategjie apo plani zhvillimi vendor për punësimin e të rinjëve dhe grave;
- Të ndërtohen grupe pune që evidentojnë problemet e zonave rurale dhe të ndihmojnë në përgatitjen e aplikimeve për skemat e ndryshme të mbështetjes së fermerëve;
- Këshilli Bashkiak të ndërtojë mekanizma të gjithpërfshirjes qytetare në vendimmarrje;
- Nevojitet më tepër bashkëpunim me organizatat jo fitimprurëse dhe grupet e interesit, për të zhvilluar një proces efektiv të buxhetimit me pjemarrje, konsultimit dhe të dëgjësive publike;

- Këshilli Bashkiak mund të realizojë marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi me organizata dhe grupe interesi, për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke bërë procese efektive dhe transparente.
- Të lehtësohet komunikimi ndërmjet qytetarëve dhe institucionit të Bashkisë Pukë, duke formuluar një strategji dhe për moshta e treta që nuk mund të aksesojnë faqen e ëëb apo rrjetet sociale.
- Të parashikohet vendosja e dy vetratave të reja në pallatin afër Drejtorisë së Policisë;
- Bashkia të shikojë me prioritet çdo ankesë të banorëve të saj
- Të zhvillohen takime më të shpeshta me banorët e njësive administrative për të marrë problemet kryesore të tyre në çdo sezon të vitit.
- Të zëvendësohen koshat e amortizuar të mbledhjes së mbeturinave.

Aneks

Aneks 1: Prioritetet e kontratës Sociale

Prioritet 1: Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:

- Të rinjtë e sapo diplomuar
- Gratë
- Gratë viktime të dhunës në familje

Prioritet 2: Adresimi me prioritet i rregullimit të rrugëve në nivel bashkie.

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i vendosjes së transportit publik, sidomos në ato zona ku mungon totalisht.

Prioritet 4: Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Prioritet 5: Ngritja e programeve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuere kundër dhunës me bazë gjinore.

Prioritet 6: Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në Njësitë Administrative dhe zonat periferike ku mungojnë dhe kontroll më i shpeshtë nga Bashkia.

Prioritet 7: Adresimi dhe rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm i shkollave dhe fshatrave si dhe kontrolli i cilësisë së tij.

Prioritet 8: Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që, qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.

Prioritet 9: Ngritja e akademisë sportive (zhvillimi i shumësporteve për aktivizimin rinor).

Prioritet 10: Lobimi dhe mbështetja nga Bashkia në lidhje me bursat e ekselencës.

Prioritet 11: Nevoja për hapjen e kurseve profesionale me bazë zhvillimin e aftësive për turizëm, si një fushë prioritare e zhvillimit të Pukës, duke sjellë kështu edhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe grave.

Prioritet 12: Zhvillimi dhe identifikimi i zonave turistike, tabelave informuese, shtigjeve malore dhe informacion më të zgjeruar për zhvillimin e zonës së Pukës.

Prioritet 13: Kërkesa për të hapur një Qendër Rinore.

Prioritet 14: Rishikimi i ndihmës ekonomike, veçanërisht për gratë kryefamiljare, të divorcuara dhe ato të dhunuara.